



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA KAMËZ
DREJTORIA E MEDIAS**

PROCESVERBAL

**I KONSULTIMT PUBLIK PËR MIRATIMIN E PROGRAMIT BUXHETOR
AFATMESËM 2027-2029 DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË KAMËZ
PËR VITIN 2027.**

I mbajtur më 09.09.2026, në orën 19:00, në dëgjese me banorët e Njesisë Administrative Paskuaqn, në lidhje me konsultimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 dhe Detajimin e Buxhetit për vitin 2027, për Bashkinë Kamëz.

Takimi u zhvillua në Amfiteatrin e Parkut të Liqenit të Paskuqanit.

Të pranishëm në takim:

- Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli;
- Drejtuesi Politik i Qarkut Tiranë, z. Taulant Balla;
- Kryetari i Këshillit Bashkiak Kamëz, z. Hysen Koldashi;
- Administratori i Njesisë Administrative Paskuqan, z. Eduart Bodini;
- Antarë të Këshillit Bashkiak Kamëz;
- Ndërlidhsit me Komunitetin;
- Banorë të zonës.

Takimin e hapi Kryetari i Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli, i cili falënderoi Drejtuesin Politik të Qarkut Tiranë, z. Taulant Balla, për mbështetjen e vazhdueshme që prej 7 gushtit 2019, si dhe të pranishmit për pjesëmarrjen në këtë dëgjese publike.

Kryetari Suli theksoi se, që prej 7 gushtit 2019, vendimet janë marrë në bashkëpunim me qytetarët, Këshillin Bashkiak dhe administratën e Bashkisë Kamëz.

Në vijim, Kryetari Suli u ndal te rëndësia e bashkëpunimit me qytetarët dhe mënyra e realizimit të investimeve, duke theksuar:

“Ne “Praninë besnike” e kemi nisur që në vitin 2019 dhe e kemi implementuar prej shtatë vitesh, duke u mbështetur në tre faktorë të rëndësishëm: së pari, marrjen e vendimeve në mënyrë të përbashkët, së dyti, informimin e qytetarëve për investimet që do të realizohen, dhe së treti, informimin e tyre për mënyrën se si do të implementohen këto projekte.

Nëse unë, si Kryetar Bashkie, do t'u kisha thënë qytetarëve më 7 gusht 2019 të gjitha këto premtime, askush nuk do t'i kishte besuar. Ne bëmë një revolucion dhe këtë e realizuam së bashku me Këshillin Bashkiak dhe administratën e Bashkisë Kamëz. E kemi bërë si një familje e madhe, ku ekziston besimi te kryefamiljari. Ne i kishim të qarta objektivat që më 7 gusht 2019, kur u betuam para Kushtetutës. E them shpesh: morali mbi ligjin. Qëllimi ynë, së bashku me Këshillin Bashkiak, ishte rikthimi i besimit të qytetarëve te Bashkia Kamëz.

Nëse do të flasim për investimet e realizuara, ne nuk kemi bërë investime vetëm për të sotmen. Ne kemi bërë investime për breza të tërë. Ky është vizioni i një Kryetari Bashkie dhe ky është vizioni i një administrate,” u shpreh zoti Suli.

Me pas, kryetari Suli u ndal te punët e realizuar nga viti 2019-2025, investimet në proces për vitin 2026 dhe projektbuxheti për vitin 2027.

❖ **Investimet e realizuara gjatë periudhës 2019–2025**

➤ **Arsimi**

Janë ndërtuar nga e para dhe rikonstruktuar 43 objekte arsimore, konkretisht:

- 19 shkolla;
- 17 kopshte;
- 7 çerdhe;
- 5,900 fëmijë në kopshte dhe çerdhe.

➤ **Infrastrukturë rrugore**

Infrastruktura rrugore e përfunduar për periudhën 2019-2025 përfshin 304 km rrugë:

- Në Njësinë Administrative Paskuqan të përfunduar 101.5 km rrugë;
- Në Lagjen Administrative Bathore të përfunduar 73 km;
- Në Lagjen Administrative Laknas–Valias të përfunduar 69.9 km;
- Në Lagjen Administrative Nr.2 të përfunduar 59.7 km.

➤ **Ndriçimi publik**

Janë përfunduar 286 km rrjet ndriçimi publik.

➤ **Ujësjellësi**

Mbulimi me rrjetin e ujësjellësit ka arritur në 95% në territorin e Bashkisë Kamëz:

- Në Njësinë Administrative Paskuqan mbulim 100%;
- Në Lagjen Administrative Bathore mbulim 100%;
- Në Lagjen Administrative Nr. 2 mbulim 100%;
- Në Lagjen Administrative Nr.1 mbulim 95%.

➤ Kanalizimet

Mbulimi me rrjetin e kanalizimeve ka arritur në 95%.

➤ Strehëza e Qenve

Janë krijuar dhe funksionojnë strehëzat për qentë, si pjesë e shërbimeve dhe menaxhimit të kafshëve endacake.

➤ Pastrimi i qytetit

Nga data 28 mars 2024, shërbimi i pastrimit të qytetit menaxhohet nga Bashkia.

- 18 mjete për pastrim;
- 290 pika grumbullimi të mbetjeve.

➤ Shërbimi zjarrfikës

- Ndërtimin e stacionit zjarrfikës;
- 5 mjete zjarrfikëse;
- Blerjen e uniformave për personelin;
- Janë dëmshpërblyer nga bashkia të gjitha familjet të cilave u është djegur shtëpia.

➤ Transporti Publik Urban

Është zhvilluar dhe përmirësuar shërbimi i Transportit Publik Urban, me synim rritjen e cilësisë dhe aksesueshmërisë së transportit për qytetarët.

➤ Sinjalistika rrugore

Janë realizuar investime në sinjalistikën rrugore, me qëllim rritjen e sigurisë dhe orientimit në rrugët e qytetit.

- Vendosja e semaforve.

➤ 4 projekte banesash të miratuara nga Bashkia Kamëz:

- Modeli 1+1, me sipërfaqe 66.1m²;
- Modeli 2+1, me sipërfaqe 95 m²;
- Modeli 3+1, me sipërfaqe 104.5 m²;
- Modeli 3+1, me sipërfaqe 109.8 m².

➤ Rindërtimi Valias

- 19 Pallate;
- 270 apartamente;
- Rindërtimi nga tërmeti: 426 banesa individuale.

➤ Rikonstrukimi i pallateve të vjetra 54 pallate, 831 familje përfituese

- Qendër Kamëz, 32 pallate/ 490 familje përfitues;
- Babrru Qendër, 16 pallate/ 250 familje përfituese;
- Paskuqan, 2 pallate/22 familje përfituese;
- Laknas, 4 pallate/69 familje përfituese.

➤ Hapësirat publike

Në kuadër të përmirësimit të cilësisë së jetës dhe krijimit të hapësirave të reja rekreative, janë krijuar dhe rehabilituar 103 hektarë hapësira publike.

Parku i Liqenit të Paskuqanit

Një nga investimet kryesore është Parku i Liqenit të Paskuqanit, me një sipërfaqe prej 84 hektarësh, i cili përfshin:

- 5.1 km pedonale;
- 2 zona parkimi;
- Pemë të mbjellura 152.000 mijë;
- Amfiteatrin;
- Mol;
- Shkallë panoramike.

Pedonalja e Frutikulturës

- Gjatësi: 1.3 km;
- Sipërfaqe: 7,350 m².

Pedonalja e Bathores

- Gjatësi: 1 km;
- Sipërfaqe: 7,000 m²;

Stadiumi i Valiasit

- Fushë sportive;
 - Parking.
- Ndërtimi i Urës së Paskuqanit
- Të rinjtë
- 2,028 bursa ekselence;
 - 173 ekiye sportive, me rreth 3,500 të rinj të përfshirë;
 - Panairi i Librit “Kamza Lexon”;
 - Klubi i Librit;
 - Konkurse kulturore për të rinjtë;
 - Këshilli Rinor;
 - Karta e Studentit;
 - Abone për studentët.

❖ Investime në proces për vitin 2026

- Infrastruktur rrugore në proces 100.8 km, 475 rrugë:

- Paskuqan, 40 km;
- Bathore 6.8 km;
- Laknas-Valias 21 km;
- Lagjja Administrative Nr 2, 33 km.

- Ndriçim në proces 95km

- Objekte arsimore që hapen në shtator 2026

- Gjimnazi “Sulejman Elezi”;
- Shkolla “Murat Toptani”;
- Kopshti “Montessori”.

- Përfundon ndërtimi i godinës së Bashkisë Kamëz:

- Siperfaqe 14.555 m²;
- Objekt 3 katësh.
- Parkim nëntokësor.

❖ **Politikat ekonomike sociale për vitin 2027**

- 363 familje përfitojnë bonus qiraje si të pastrehë – 108,900,000 lekë;
 - 208 familje të prekura nga projekti i Unazës së Madhe – 55.320.000 lekë;
 - Fëmijët me status jetimi – 5,000 lekë/muaj;
 - Të moshuarit e vetmuar – 5,000 lekë/muaj;
 - Trajtim për familje me problematika ekonomike dhe sociale nga buzheti i Bashkisë – 27.000.000 lekë;
 - 530 fëmijë të familjeve në nevojë përfitojnë ushqim falas në çerdhe dhe kopshte;
 - 85 fëmijë trajtohen në Qendrën Multifunkionale;
 - 84 persona me aftësi të kufizuara përfitojnë shërbim lëvizës në banesë (logopedi, fizioterapi, psikologji);
 - 60 familje përfitojnë kredi të buta;
 - 42 familje përfitojnë nga programi i përmirësimit të banesave – 46.000.000 Lekë.
- 500 përfitues nga shërbimi lëvizës.

❖ **Investimet e planifikuara për vitin 2027:**

- Infrastruktur rrugore të planifikuara për vitin 2027 , 34.5km, 170 rrugë nga të cilat:
1. Riasfaltim 14.8 km;
 2. Investim nga e para 20.7 km.
 - Paskuqan 7 km;
 - Bathore 5.5 km;
 - Laknas – Valias 17.2 km;
 - Lagjja Administrative nr.2, 4.8 km.
- Pedonalja Valias.
- Gjimnazi “Elez Isuf Ndreu” me siperfaqe 4095 m².
- Ura në Paskuqan 2, e cila mundëson hyrje-daljen në Unazën e Madhe.
- Projekti ujësjellësit të Bovillës së Vjetër.

Më pas, Kryetari Rakip Suli u ndal te projekti i ujësjellësit të Bovillës së Vjetër, duke e cilësuar investimin në ujësjellësin e Bovillës së Vjetër si sfidën më të madhe, pasi zgjidhja e plotë e kësaj problematike nuk është në kompetencën e drejtpërdrejtë të Bashkisë. Ai theksoi se projekti,

është hartuar dhe dorëzuar në fazën e parë dhe se realizimi i tij në vitin 2027 do të mundësonte furnizimin 24 orë me ujë, nga Fushë-Kërçiku deri në Rinas.

Më pas, fjalën e mori Drejtuesi Politik i Qarkut Tiranë, z. Taulant Balla, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe Kryetarin e Bashkisë Kamëz, z. Rakip Suli.

Gjatë fjalës së tij, z. Balla vlerësoi punën e Kryetarit të Bashkisë dhe transformimin e Kamzës gjatë viteve të fundit, duke u shprehur: “Sot, pas 7 vitesh, askush nuk e kishte besuar se ky ndryshim kaq i madh do të ndodhte në një kohë kaq të shkurtër. Besa jonë me Kamzën, përmes Rakip Sulit, ka funksionuar gjithnjë. Në këtë proces të rëndësishëm vendor, besoj se për Kamzën kandidati nuk do të ndryshojë. Rakip Suli nuk është thjesht kandidat, por Kryetari i Bashkisë, i cili do të marrë përsipër mandatin katërvjeçar 2027-2031. Katër tiparet kryesore të besës: besimi, empatia, shërbimi dhe angazhimi, Rakip Suli i mishëron më së miri”, u shpreh z. Balla.

Më tej, z. Balla u ndal te investimet e planifikuara për vitin 2027, duke theksuar rëndësinë e ndërhyrjeve në sektorin e ujësjellësit të Bovillës së Vjetër: “Është e vërtetë që pjesa e ujësjellësit të vjetër të Bovillës nuk është detyrë e jotja, por e imja, dhe unë do të garantoj se do ta mbaj fjalën time”, deklaroi z. Balla.

Në vijim, ai vlerësoi përfundimin e procesit të rindërtimit në Kamëz dhe shprehu pritshmërinë që familjet përfituese të pajisen me certifikatat e pronësisë:

“Më vjen mirë për atë që është bërë me rindërtimin. Është e vërtetë që Kamza e ka përfunduar rindërtimin dhe shpresoj shumë që deri në Vitin e Ri, të gjitha familjet që kanë përfutur nga rindërtimi, së bashku me Rakipin, të marrin në shtëpitë e tyre edhe certifikatën e pronësisë”, u shpreh z. Balla.

Më tej, z. Balla vlerësoi punën e bërë për ndërtimin dhe zhvillimin e Parkut të Paskuqanit, duke theksuar se puna do të vijojë me shtimin e gjelbërimit dhe të numrit të pemëve, përmes një projekti të ri në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit.

Në vijim, ai u ndal te investimet në arsim, duke e cilësuar Kamzën si një histori suksesi në këtë fushë. Ai theksoi se gjatë 7 viteve janë ndërtuar 19 shkolla, 17 kopshte dhe 7 çerdhe, duke i lidhur këto investime edhe me përmirësimin e rezultateve të arsimit në Shqipëri.

Gjithashtu, z. Balla prezantoi mundësi të reja për të rinjtë e Kamzës në fushën e teknologjisë së informacionit. Ai bëri të ditur se është pothuajse finalizuar një projekt në bashkëpunim me fondin Shqiptaro-Amerikan, i cili do t’u mundësojë të rinjve të Kamzës ndjekjen falas të kurseve të teknologjisë së informacionit, përfshirë programimin dhe inteligjencën artificiale.

Në kuadër të këtij projekti, Bashkia Kamëz do të ofrojë ambientet e nevojshme pranë Qendrës Kulturore në qendër të Kamzës. Projekti parashikon mbështetje prej 2 milionë eurosh nga Qeveria Shqiptare dhe 3 milionë dollarësh nga fondi amerikan.

Takimi u mbyll me një përshëndetje për të gjithë të pranishmit në këtë dëgjese publike, duke u bërë me dije se do të nisin takimet e “Pranisë Besnike”, ku qytetarët do të kenë mundësinë të shprehin problematikat, shqetësimet dhe nevojat e tyre.

Takimi u mbyll në orën 20:40

Bashkëngjitur foto:





